



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

V E N D I M

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË UDHËZIMIN NR. 4, DATË 19.02.2013
“PËR PROCEDURAT E PËRZGJEDHJES DHE TRAJNIMIT TË SHTETASVE QË MUND TË
EMËROHEN KRYESISHT NGA KQZ, PËR PLOTËSIMIN E VAKANCËS SË KRIJUAR NË KZAZ DHE
KQV”

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në mbledhjen e tij të datës 04.04.2019, me pjesëmarrjen e:

| | | |
|---------|-----------|------------|
| Klement | ZGURI - | Kryetar |
| Denar | BIBA - | Zv/Kryetar |
| Bledar | SKËNDERI- | Anëtar |
| Edlira | JORGAQI- | Anëtare |
| Rezarta | BITRI- | Anëtare |

Shqyrtoi çështjen me:

OBJEKT: Për disa shtesa dhe ndryshime në Udhëzimin nr. 4, datë 19.02.2013 “Për procedurat e përzgjedhjes dhe trajnimit të shtetasve që mund të emërohen kryesisht nga KQZ për plotësimin e vakancës së krijuar në KZAZ dhe KQV”.

BAZA LIGJORE: Neni 23, pika 1 gërma "a", pika 2 dhe 5, neni 29, pika 5, neni 36, pika 5, të Kodi Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur si dhe dëgjoi diskutimet e përfaqësuesve të partive politike,

VËREN

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në zbatim të urdhërimeve të nenit 29, pika 5, të Kodit Zgjedhor, ka miratuar Udhëzimin nr. 4, datë 19.02.2013 “Për procedurat e përzgjedhjes dhe trajnimit të shtetasve që mund të emërohen kryesisht nga KQZ për plotësimin e vakancës së krijuar në KZAZ dhe KQV”.



Nr 127 i Vendimit Data 04.04.2019 e Vendimit Ora 11.00 e Vendimit

Për disa shtesa dhe ndryshime në Udhëzimin nr. 4, datë 19.02.2013 “Për procedurat e përzgjedhjes dhe trajnimit të shtetasve që mund të emërohen kryesisht nga KQZ për plotësimin e vakancës së krijuar në KZAZ dhe KQV”

Bazuar në aktin normativ sipërcituar, KQZ-ja ka kryer procedurat për emërimin kryesisht dhe trajnimin e shtetasve për të plotësuar vendet vakante në Komisionet e Zonave të Administrimit Zgjedhor dhe në Komisionet e Qendrave të Votimit, për zgjedhjet për për Kuvendin 2013, 2017, dhe zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore 2015.

Përzgjedhja e shtetasve për emërimin kryesisht anëtar apo sekretar të KZAZ/KQV, mbi bazën e kriterit të përcaktuar, atë të dhënies përparësi të trajnimeve në fushën e zgjedhjeve, eksperiencave të mëparshme në administratën zgjedhore dhe kualifikimeve profesionale, ka dëshmuar vështirësi për zbatim në rastet kur numri i shtetasve që i plotësojnë kriteret ka qënë më i madh se numri i vakancave.

Detajimi i procedurave për përzgjedhjen e shtetasve që emërohen kryesisht për plotësim të vakancave, si në rastet kur ato zbatohen nga KQZ apo nga KZAZ, rrit transparencën në organizimin dhe administrimin e procesit zgjedhor, rrit sigurinë e kryerjes së procedurave në respektim të plotë të përcaktimeve ligjore.

Bazuar në përcaktimet e pikës 4 të nenit 23 të Kodit Zgjedhor, të ndryshuar, aktet normative të KQZ kanë karakter të përhershëm dhe zbatohen si rregull në të gjitha zgjedhjet. Këto akte rishikohen për shkak të ndryshimit të ligjit apo për shkaqe të tjera që përlligjin ndryshimin e tyre.

KQZ në përmbushje të kompetencës për drejtimin dhe kontrollin e procesit zgjedhor, rishikon Udhëzimin nr. 4, datë 19.02.2013 "Për procedurat e përzgjedhjes dhe trajnimit të shtetasve që mund të emërohen kryesisht nga KQZ për plotësimin e vakancës së krijuar në KZAZ dhe KQV", duke e plotësuar dhe ndryshuar sa i përket procedurave të përzgjedhjes për emërimet kryesisht për plotësimin të vakancave, nga lista e shtetasve të miratuar me vendim të KQZ.

PËR KËTO ARSYE

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, bazuar në nenin 23, pika 1, gërma "a", pika 2 dhe 5, nenin 29, pika 5, neni 36, pika 5, të Kodi Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë,

V E N D O S I:

1. Në Udhëzimin nr. 4, datë 19.02.2013 "Për procedurat e përzgjedhjes dhe trajnimit të shtetasve që mund të emërohen kryesisht nga KQZ për plotësimin e vakancës së krijuar në KZAZ dhe KQV", bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1.1 Neni 2, pika 3 dhe 4, ndryshohen si vijon:

" 3. Drejtorja e Komisioneve Zgjedhore, shqyrton të gjitha kandidaturat e paraqitura në KQZ, apo pranë zyrave rajonale zgjedhore, duke krijuar një listë me të gjithë personat të cilët plotësojnë kërkesat e nenit 30 dhe 31 të Kodit Zgjedhor dhe ia paraqet për miratim KQZ-së.



Nr 127 i Vendimit Data 04.04.2019 e Vendimit Ora 11.00 e Vendimit

Për disa shtesa dhe ndryshime në Udhëzimin nr. 4, datë 19.02.2013 "Për procedurat e përzgjedhjes dhe trajnimit të shtetasve që mund të emërohen kryesisht nga KQZ për plotësimin e vakancës së krijuar në KZAZ dhe KQV"

4. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, miraton me vendim listën e shtetasve që mund të emërohen kryesisht për të plotësuar vende vakante për anëtar dhe sekretar të KZAZ-së.”

1.2 Pas nenit 2, shtohet neni 2/1 me këtë përmbajtje:

**“Neni 2/1
Procedura e shortit në KQZ**

1. Në rast se në listën e miratuar nga KQZ numri i shtetasve me vendbanim në zonën zgjedhore përkatëse është më i madh se numri i vakancave, përzgjedhja e shtetasve për tu emëruar kryesisht si anëtar apo sekretar i KQZ do të bëhet me short i cili organizohet në seancë publike.
2. Kur në zonën zgjedhore përkatëse ka vakanca për pozicionin e sekretarit edhe të anëtarit të KZAZ, i pari hidhet shorti për sekretar të KZAZ dhe më pas shorti për anëtar të KZAZ-së.
3. Për përzgjedhjen e sekretarit të KZAZ-së, ndiqet procedura:
 - a. Në një enë transparente futen aq gogla me formë dhe ngjyrë të njëjtë sa është numri i shtetasve pjesëmarrës në short;
 - b. Në secilën prej goglave mbyllet nga një shirit letre ku shënohet emri i shtetasit pjesëmarrës në short;
 - c. KQZ cakton një nëpunës nga stafi i KQZ-së për të tërhequr goglën;
 - d. Nëpunësi i KQZ-së tërheq nga ena njërën nga goglat, e hap dhe lexon emrin e shtetasit që është shënuar në shiritin brenda goglës dhe ia jep Sekretarit të KQZ-së.
 - e. Në rastet kur në zonën zgjedhore përkatëse ka më shumë se një KZAZ që kanë vakant pozicionin e sekretarit:
 - nëpunësi i KQZ-së do të tërheqë nga ena, me radhë, aq gogla sa është numri i KZAZ-ve që kanë vakant pozicionin e sekretarit;
 - shorti i tërhequr në radhë i korrespondon numrit të KZAZ-së në progresion rritës.
 - f. Shtetasit, emrat e të cilëve janë të mbyllur në goglat e mbetura në enë pas përfundimit të hedhjes së shortit për sekretar të KZAZ, marrin pjesë në shortin për anëtar të KZAZ-së në zonën zgjedhore përkatëse.
4. Për përzgjedhjen e anëtarit të KZAZ-së, ndiqet procedura:
 - a. Në një enë transparente futen aq gogla me formë dhe ngjyrë të njëjtë sa është edhe numri i shtetasve pjesëmarrës në short;
 - b. Në secilën prej goglave mbyllet nga një shirit letre ku shënohet emri i shtetasit pjesëmarrës në short;
 - c. KQZ cakton një nëpunës nga stafi i KQZ-së për të tërhequr goglën;
 - d. Nëpunësi i KQZ-së tërheq nga ena njërën nga goglat, e hap dhe lexon emrin e shtetasit që është shënuar në shiritin brenda goglës dhe ia jep Sekretarit të KQZ-së.
 - e. Në rastin kur në zonën zgjedhore përkatëse ka më shumë se një KZAZ që kanë vakant pozicionin e anëtarit:



Nr 127 i Vendimit Data 04.04.2019 e Vendimit Ora 11.00 e Vendimit

Për disa shtesa dhe ndryshime në Udhëzimin nr. 4, datë 19.02.2013 “Për procedurat e përzgjedhjes dhe trajnimit të shtetasve që mund të emërohen kryesisht nga KQZ për plotësimin e vakancës së krijuar në KZAZ dhe KQV”

- nëpunësi i KQZ-së do të tërheqë nga ena, me radhë, aq gogla sa është numri i pozicioneve vakante;
 - shorti i tërhequr në radhë i korrespondon numrit të vakancave sipas numrit të KZAZ-së në progresion rritës.
5. KQZ, në çdo rast, emëron me vendim kryesisht anëtarin apo sekretarin e KZAZ-së.”

1.3 Neni 3, pika 3 dhe 4, ndryshohen si vijon:

“3. Drejtoria e Komisioneve Zgjedhore, shqyrton të gjitha kandidaturat e paraqitura në KQZ apo pranë zyrave rajonale, të cilët plotësojnë kërkesat e nenit 37 dhe 38 të Kodit Zgjedhor dhe ia paraqet për miratim KQZ-së.

4. KQZ miraton me vendim për çdo zonë zgjedhore, listën e shtetasve që mund të emërohen kryesisht anëtarë apo sekretarë të KQV-ve dhe ja dërgon KZAZ-ve përkatëse.”

1.4 Pas nenit 3, shtohet neni 3/1 me këtë përmbajtje:

**“Neni 3/1
Procedura e shortit në KZAZ**

1. Komisioni i Zonës së Administrimit Zgjedhor, për plotësimin kryesisht të vakancës emëron sipas rastit anëtarin apo sekretarin e KQV-së, me emrat nga lista e miratuar me vendim të KQZ-së.
2. Kur numri i shtetasve në listën e miratuar nga KQZ është më i madh se numri i vakancave, KZAZ organizon në seancë publike hedhjen e shortit sipas kësaj procedure:
 - a. Në një enë transparente futen aq gogla me formë dhe ngjyrë të njëjtë sa është numri i shtetasve në listën e miratuar nga KQZ;
 - b. Në secilën prej goglave mbyllet nga një shirit letre ku shënohet emri i shtetasit pjesëmarrës në short;
 - c. Sekretari i KZAZ tërheq nga ena njërën nga goglat, e hap dhe lexon emrin e shtetasit që është shënuar në shiritin brenda goglës.
 - d. KZAZ, në përfundim të kësaj procedure, me vendim emëron kryesisht anëtarin apo sekretarin e KQV-së sipas rezultatit të shortit.
3. Kur në Zonën e Administrimit Zgjedhor përkatës ka më shumë se një KQV që kanë vakant pozicionin e anëtarit apo sekretarit, KZAZ organizon në seancë publike hedhjen e shortit sipas kësaj procedure:
 - a. liston të gjitha QV-të, KQV e të cilave janë pa kuorum, duke i renditur nga QV-ja me numër më të vogël dhe duke vazhduar në rend rritës. QV-të bija renditen pas QV-së së origjinës;
 - b. QV-të e renditura sipas pikës “a”, numërtohen nga KZAZ-ja duke filluar nga numri 1 e duke vazhduar progresivisht deri në numërtimin e QV-së së fundit;
 - c. Sekretari i KZAZ do të tërheqë nga ena, me radhë, aq gogla sa është numri i vakancave në KQV-të e ZAZ përkatëse;



Nr 127 i Vendimit Data 04.04.2019 e Vendimit Ora 11.00 e Vendimit

Për disa shtesa dhe ndryshime në Udhëzimin nr. 4, datë 19.02.2013 “Për procedurat e përzgjedhjes dhe trajnimit të shtetasve që mund të emërohen kryesisht nga KQZ për plotësimin e vakancës së krijuar në KZAZ dhe KQV”

- d. Shorti i tërhequr në radhë i korrespondon komisioneve të QV-ve sipas numërimit të pikës "b";
- e. KZAZ-ja, në përfundim të kësaj procedure, me vendim emëron kryesisht anëtarin apo sekretarin e KQV-së, sipas rezultatit të shortit."

2. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, brenda 5 ditëve nga shpallja e tij.

| | | |
|----------------|------------------|-------------------|
| Klement | ZGURI - | Kryetar |
| Denar | BIBA - | Zv/Kryetar |
| Bledar | SKËNDERI- | Anëtar |
| Edlira | JORGAQI- | Anëtare |
| Rezarta | BITRI- | Anëtare |



Nr 127 i Vendimit Data 04.04.2019 e Vendimit Ora 11.00 e Vendimit

Për disa shtesa dhe ndryshime në Udhëzimin nr. 4, datë 19.02.2013 "Për procedurat e përzgjedhjes dhe trajnimit të shtetasve që mund të emërohen kryesisht nga KQZ për plotësimin e vakancës së krijuar në KZAZ dhe KQV"